

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 43 datë 27.7.2021

**“PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDITËSUAR TË KUFIJVE
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALË TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË
BASHKISË SHKODËR, PA NDRYSHUAR KUFIRIN ADMINISTRATIVO
TERRITORIAL TË NJËSISË SË VETQEVERISJES VENDORE/BASHKISË
SHKODËR”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 27.7.2021, me propozim të Kryetares së Bashkisë, mbështetur në nenin 93 pikë 2 ligji nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; ligji nr. 115/2014 date 31.07.2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverijes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; VKM nr 360 dt 29.05.2019 “ Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrative territoriale të Njësive të vetqeverisjes vendore “,“VKM nr.459, datë 16.6.2010 ” Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të Njësive Administrative të Bashkisë Shkodër, pa ndryshuar kufirin administrativo territorial të njësisë së vetqeverisjes vendore/bashkisë Shkodër”, sipas standardeve gjeohapësinore, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lasha


Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 2.8.2021



Legjenda

- Kufi ekzistues i njësive administrative (2014)
- Kufiri i përditësuar i njësive administrative në territorin e Bashkisë Shkodër
- Kufiri i Bashkisë Shkodër VKM 360, 29.05.2019